

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E MAMUSHËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-26-2279-5-5-8
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	ARITECH SHPK
NUI	810821828
Adresa	KM 10 PRISHTINE-LIPJAN, PERBALL QMI-se
Vendi	GRACANICE
Kodi postar	10500
Numri Telefonit	038/600 500
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Faton Ibrahim
Adresa elektronike	faton@aritechks.com
Data e parashtrimit të kërkesës	13.05.2026

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtror kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ftese për ofertim kemi pranuar me: 16.04.2026. Afati i fundit për dorëzimin e ofertav: 29.04.2026.

Data dhe ora e hapjes së ofertav: 29.04.2026. ora 14:00 Njoftimi mbi vendimin e AK: 08.05.2026.

Kriter për dhënie të kontrates: Tenderi i përgjegjshëm me cmimin me të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 28- Specifikimet teknike

Neni 52- Njoftimi i kriterëve për dhënie të kontratës Neni 59- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi I tendereve Neni 60- Kriteret për dhënie të kontrates

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 41 i UOPP-se/ Ekzaminimi, verësimi dhe krahasimi i tendereve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 08.05.2026 ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate OE INFINITT SH.P.K.

Me 11.05.2026 kemi derguar kerkese per qasje ne dokumente zyrtare dhe me 12.05.2026 AK na ka ofruar qasjen ne dokumentet e tenderit per projektin ne fjale.

Nga dokumentet te cilat kemi pranuar ne qasjen ne dokumente zyrtare konstatojme se AK ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem.

Konform nenit 6.2 te kontrates se AQP-se nr. UA/2016-23-6106-1-1-1/C403 deri C420 OE mund te aplikojne vetem me paisjet- brendin per te cilin kane dorezuar autorizim dhe jane kualifikuar ne AQP.

OE INFINITT SHPK eshte i kualifikuar me brendin HP ndersa per kete aktivitet te prokurimit ka ofruar produkte te Dell, Lenovo dhe Asus.

Per pozicionin 1 ka ofertuar PC Dell per pozicionin 2 ka ofertuar brendin Asus ndersa per pozicionin 3 produkte te Lenovos per çka nuk eshte i autorizuar ne AQP dhe nuk mund te ofertoje prandaj edhe nga AK- KK Mamushe nuk eshte dashur te rekomandoje per kontrate OE ne fjale.

Poashtu OE i rekomanduar per kontrate nga AK eshte i papergjegjshem pasiqe per pozicionin 1- PC eshte kerkuar Intel core i5 ndersa OE sipas broshurave te dorezuarra dhe modele ka ofruar intel core i3 qe eshte produkt dukshem me i lire reth 50%

AK nuk ka zotuar mjete te mjaftueshme per realizimin e kesaj kontrate, ne baze te buxhetit te planifikuar eshte e pamundur te ofrohen- dorezohen produkte sipas specifikimeve teknike ne ANEKS 1 te FPO-se.

Marr parasysh faktet e lartecakura konstatojme se AK/komisioni vlersues ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem i cili ne baze te ofertes se dorezuar nuk ploteson specifikimet teknike per PC dhe ka ofruar produkte nga prodhues per te cilet nuk eshte kualifikuar ne ofertim ne AQP.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e shkeljeve te lartecakura nga AK/komisioni vlersues ka ardhë deri tek

dhenia e kontrates per OE te papergjegjshem, ne kete menyre jane shkelur dispozitat ligjore te lartecekura.

Kerkojme nga zyrtari pergjegjes i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen (kerkesen per ri-shqyrtim) si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim ne te kunderten jemi te detyruar te dorezojme ankese ne OSHP.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*